



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E GJILANIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Mirlinda Beqiri-udhëheqës ekipi, Ejup Simnica, Besim Lezi dhe Elvir Krasniqi* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Qeverisja e mirë.....	27
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	36
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	39

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/09/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Gjilanit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se në PFV janë prezantuar keq klasifikimi i shpenzimeve në vlerë 294,013€, prej tyre 232,985€ pagesa sipas vendimeve gjyqësore apo të ekzekutuar nga thesari.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë, Komunës, Agjencisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Gjilanit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjatë vitit 2018, komuna ka paguar, regjistruar dhe prezantuar keq klasifikim të shpenzimeve në shumë prej 294,013€, për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore apo edhe planifikimit jo adekuat të buxhetit, si:

- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, Thesari ka bërë ekzekutimin e 13 pagesave në vlerë prej 28,179€, të cilat i takonin kategorisë së pagave dhe mëditje;

- Nga kategoria e subvencioneve me vendim të Qeverisë, Komunës së Gjilanit i janë ndarë subvencione për realizimin e manifestimit kulturor “Flaka e Janarit” në vlerë 54,850€¹ të cilat për nga natyra e shpenzimeve i takonin mallrave dhe shërbimeve, si dhe ndërtimi i shtëpive në vlerën 6,177€ ishte paguar nga subvencionet e jo si transfer kapital; dhe
- Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 204,807€ me vendime gjyqësore. Nga kjo shumë 176,629€ ishin shpenzime për komunal, 14,553€ shpenzime për paga dhe 13,625€ i takonte mallrave dhe shërbimeve. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Gjatë vitit 2018 dhe ma parë Komuna e Gjilanit është paditur rreth 10 milionë € në total dhe krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 1.8 milion nga ana e operatorëve ekonomik. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ketë pasoja të rënda financiare.

Vetëm gjatë vitit 2018 sipas nenit 39.2 dhe nenit 40 të LMFPP janë ekzekutuar pagesa në vlerë 500.000€, nga të cilat 37,885€ apo 7% ishin shpenzime shtesë.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Gjilanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet

¹ Nga auditimi i 4 raste në vlerë 6,190€ të gjitha ishin të keq klasifikuar, si baze është marr vlera totale e vendimit për subvencionim.

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike dhe 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë;
- Ligji i buxhetit për vitin 2018 numër 06/L-020;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës); dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me PFV-ve, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë në vijim:

- Neni 14.6: Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit - Grantet e përcaktuara të donatorëve ishin mbivlerësuar për 19,837,690€ duke e përfshirë edhe burimet nga fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës. Kjo kishte reflektuar nënvlerësimin te kolona “ Ndryshimit sipas nenit 29 (shpenzimet e pa parashikuara) të Ligjit nr 03/L-048” për menaxhimin e financave publike për 101,370€;
- Neni 17: Raporti për detyrimet (faturat) e pa paguara - nuk ishin shpalosur saktë të gjitha detyrimet. Kjo për shkak se detyrimet bazuar në vendime për subvencione të entiteteve publike të shpalosura ne PFV e vitit 2018 si 99,500€, në fillim të shkurtit të vitit 2019 ishin anuluar nga kryetari për shkaqe objektive duke ndryshuar vlerën e tyre në 8,000€, mirëpo komuna nuk i kishte ndërmarr veprime për të korrigjuar shpalosjen në pasqyra. Gjithashtu, ishin shpalosur gabimisht si obligime të vitit, fatura për rregullimin e lumenjëve në vlerë prej 22,171€, që i takonte vitit 2019. Dy fatura në shumën 24,070€ (të shpalosura si obligime dhe detyrime kontingjente në të njëjtën kohë) nuk përmbushnin kriteret për tu trajtuar si obligime, pasi i takonin detyrimeve kontingjente. Komuna në dy raste kishte paraqitur obligimin në vlerë prej 76,462€ bazuar në situacionin për pranim të punëve pa pranuar faturë. Kemi identifikuar se 14 fatura në vlerë 5,776€ të ekzekutuar si pagesa në muajteparë të vitit 2019 që ishin pranuar dhe i takonin vitit 2018, nuk ishin shpalosë si obligime në PFV;

- Neni 25: - Raporti për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave, ishte nënvlerësuar për 230 të punësuar, për faktin që nuk ishte shpalosur numri i të angazhuarve në zyrën e Kuvendit Komunal (100² të angazhuar) si dhe mungonin të dhënat për të punësuarit me orar jo të plotë nga arsimi fillor dhe i mesëm (130 të punësuar);
- Vlera totale e pasurive jo kapitale nën vlerën 1,000€ në PFV ishte 1,480,777€. Komuna nuk përdorë programi E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1000€. Komuna aplikon Excel për evidentimin e kësaj pasuri mirëpo për shkak të mundësisë së manipulimit me të dhëna dhe për shkak se nuk aplikohet zhvlerësimi i pasurisë, vlera e shpalosur e pasurisë konsiderohet si e pa saktë;
- Kemi gjetur se një pagesë në emër të shpronësimit (për përvetësimin e tokës) në shumë prej 51,601€, nuk ishte regjistruar në regjistrin kontabël, që nënkupton se pasuritë janë nënvlerësuar për këtë shumë.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve nuk është menaxhuar si duhet.

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë përveç çështje të përmendura të theksimi i opinionit dhe të pajtueshmërisë së PFV.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për theksimin e çështjes. Të gjitha shpenzimet duhet të paguhet dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit. Më tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e të gjithë pasurisë si dhe obligimeve të papaguara dhe të shpalosen drejt në pasqyrat financiare duke u mbështetur me dokumentacion përkatës.

Duhet të ndërmerren veprime specifike për çështjet tjera të ngritura lidhur me PVF, për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

² Nga 100 të angazhuar, 34 prej tyre kanë paga zero.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimit.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e menaxhimit të kontratave vazhdon të mbetet shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në përfundim të projekteve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet kërkojnë përmirësime të mëtejme për të parandaluar pa rregullsinë. Gjithashtu, fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit dhe menaxhimi i subvencioneve, pagave, klasifikimi i drejt i shpenzimeve, shpалosja e plotë dhe trajtimi me kohë i obligimeve me qëllim të eliminimit të mundësisë së përballjës me gjykatat apo me shpenzime shtesë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	24,646,974	26,511,936	24,353,251	21,945,524	21,796,138
Granti i Qeverisë -Buxheti	19,837,689	19,736,322	19,693,440	17,522,089	17,591,784
Të bartura nga viti paraprak ⁴	-	1,078,284	956,796	1,203,985	991,063
Të hyrat vetjake ⁵	4,305,358	4,305,358	3,213,264	3,078,570	2,955,200
Donacionet e brendshme	-	89,281	50,532	3,152	116,061
Donacionet e jashtme	-	798,764	439,219	137,728	142,030
Financimi nga huamarrja	503,927	503,927	-	-	-

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur 8% për 1,864,962€. Kjo rritje është rezultati të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe donacioneve të brendshme dhe të jashtme dhe ndryshimit në grandin e qeverisë.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 24,353,251€, me një përmirësim prej 1% krahasuar me vitin 2017. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	24,646,974	26,511,936	24,353,251	21,945,524	21,796,138
Pagat dhe Mëditjet	15,251,310	15,048,291	14,883,094	14,394,998	14,543,245
Mallrat dhe Shërbimet	3,264,646	3,660,414	3,205,411	2,653,764	2,602,945
Shërbimet komunale	562,200	712,510	684,100	496,834	547,743
Subvencionet dhe Transferet	554,086	1,038,177	778,398	536,720	732,119
Investimet Kapitale	5,014,732	6,052,544	4,802,248	3,863,208	3,370,086

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 79% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe disa projekte të reja për vitin aktual;
- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje ishte në vlerë prej 203,019€. Kjo si rezultat i shkurtimit buxhetor nga ana e Qeverisë në shumën 306,217€ si dhe rritjes së donacioneve, dhe të hyrave në vlerë totale 103,198€;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 395,768€ përfshin të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm prej 254,000€ dhe si dhe nga fondet e donatorëve të jashtëm prej 141,768€;
- Buxheti për komunalitet ishte rritur për 150,310€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë për shlyerjen e borxheve nga kjo kategori e po ashtu me vendim të Qeverisë ishin rritur edhe subvencionet për realizimin e Manifestimit kulturor “Flaka e Janarit”. Kjo kategori është rritur me bartjen e 49,029€ nga të hyrat lokale të vitit paraprak si dhe donacionet e brendshme e jashtme në vlerë totale 380,213€; si dhe
- Komuna e Gjilanit ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët vendorë në vlerën 888,045€, të cilat ishin alokuar për subvencione dhe përkrahje të bujqësisë por edhe investime kapitale.

Çështja A1⁶ - Realizimi i ulët i buxhetit për Investime kapitale dhe Subvencione

Gjetja Komuna gjatë këtij viti ka arritur të shpenzoj buxhetin për investime kapitale vetëm 79% si dhe 75% për subvencione. Ekzekutimi i ulët lidhur me projektet kapitale dhe subvencione është ndër sfidat kryesore me të cilën po përballet komuna. Çështja nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit edhe pse ajo është trajtuar në raportet e mëparshme të auditimit. Shkaktar të ekzekutimit të ulët janë vonesat në realizimin e kontratave.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale dhe subvencioneve mund të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Gjilanit në vitin 2018 ishin në shumë prej 3,360,094€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,305,358	4,305,358	3,360,094	3,672,615	3,763,189
Totali	4,305,358	4,305,358	3,360,094	3,672,615	3,763,189

Përpos të dhënave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë 823,646€ (dënimet në trafik 669,769€, të hyrat nga Gjykatat 132,474€ si dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 21,403€). Në krahasim me vitin 2017, arkëtimi i të hyrave ka pësuar një rënie prej 8.5% apo në vlerë 312,521€.

Bartja e të hyrave vetjake të komunës në vitin 2019 është në vlerë prej 1,091,964€.

⁶ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Çështja A2 - Parregullsi në kalkulimin e të hyrave nga tatimin në pronë

Gjetja Sipas nenit 9 të Ligjin nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos që prona ose njësia e banimit që shërben si vend kryesor për banim, i lejohe zbritja prej dhjetëmijë euro (10,000€) nga vlera e tatueshme e pronës. Gjatë testimeve tona në tetë raste tatimpaguesve të njëjtë i janë njohur dy e më shumë prona si banim kryesor, kjo ka ndikuar që të hyrat në këto raste të nënvlerësohen për 150€/në vit.

Sipas nenit 6 pika 1.8 të udhëzimit administrativ nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin përshkruhen në hollësi kategoritë e vlerësimit të pronave. Në 9 raste pronat të cilat i takonin kategorisë së vlerësimit komerciale-dyqane ishin kategorizuar si depo magazinë. Kjo kishte ndikuar në ulje të vlerës së këtyre pronave dhe rrjedhimisht nënvlerësim të ngarkesës tatimore në shumë prej 658€/vit.

Po ashtu, sipas rregullores komunale për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2018 nr.01/016-64724 e dt.29.06.2017, duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Gjiçanit janë përcaktuar 5 zona, në kuadër të zonës së parë përfshihen edhe 2 nën zona (I-A dhe I-B). Në gjashtë raste kemi identifikuar se prona tatimore nuk ishte vlerësuar sipas zonave tatimore të përcaktuara në rregullore, në një rast tatimi për këtë pronë ishte përlllogaritur duke marrë për bazë zonën e II ndërsa sipas rregullores i takonte zonës IB, në një rast tjetër prona ishte vlerësuar duke marrë për bazë zonën II, ndërsa i përkisnin zonës IA. Kjo ka ndikuar në nënvlerësim të obligimit tatimor në shumë prej 76.72€/vit.

Këto gabime ishin si rezultat i angazhimit të anketuesve jo profesional në teren për verifikimin e gjendjes ekzistuese të pronave krahasuar me të dhënat në sistem, si dhe për shkak të mungesës së rishikimit nga ana e zyrtarit përgjegjës komunal për tatimin në pronë i cili duhet t'i rishikojë të gjitha të dhënat si dhe të bëjë verifikimin dhe konfirmimin e tyre.

Rreziku Situata të kësaj natyre rezultojnë me ngarkesa të pasakta të tatimit në pronë dhe në këtë mënyrë të dëmtojë buxhetin e komunës në rastet e nënvlerësimit të obligimit tatimor.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të kërkojë nga menaxheri i tatimit në pronë që gjatë procesit regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes jo vetëm regjistrimit të pronave të reja dhe ndryshimeve fizike që ndodhin në pronat ekzistuese dhe por edhe korrigjimet e dobësive të identifikuara të cilat kanë të bëjnë me informatat e pronave të tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që përlllogaritjet e ngarkesave tatimore të jene sa më reale.

Çështja A3- Informata jo të plota në dosjet e tatimpaguesve

Gjetja Sipas nenit 14 të UA nr.03/2011 me rastin e regjistrimit të të dhënave në sistem nga operatorët merren këto të dhëna: numri i ndërtesës, numri i njësisë dhe numri i tatimpaguesit, gjithashtu neni 5.8 i të njëjtit udhëzim parasheh që dosjet e tatimpaguesve të përmbajnë edhe fotografitë e objekteve. Nga dhjetë rastet e audituara në shtatë prej tyre tatimpaguesit kishin marrë më shumë se njënumër identifikues, gjë që ishte e pamundur konfirmimi i përfitimit të zbritjes për banim primar në më shumë se një pronë, në tetë nga dhjetë rastet e audituara mungonin fotografitë në disa nga pronat e tatimpaguesve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive të programit Protax, neglizhencës të anketuesve në teren si dhe mungesës së rishikimit të zyrtarëve që fusin të dhënat në sistem.

Rreziku Mangësitë e identifikuar në bazën e të dhënave dhe informata jo të plota në dosjet e tatimpaguesve rezultojnë me gjendje jo reale të pronave të tatueshme dhe vështirëson kalkulimin e drejtë të tatimit në prone.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e Tatimit në Pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuar, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e atij plani duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuar.

Çështja A4 - Prona komunale të dhëna në shfrytëzim të përkohshëm pa procedura të ankandit

Sipas Ligjit Nr. 04/L-144 në nenet 5 dhe 6 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, është paraparë që dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë bëhet përmes procedurave të ankandit publik të cilat rregullohen me akt nënligjor. Nga tetë mostra e audituara kemi identifikuar se në katër raste prona komunale ishte dhënë në shfrytëzim me kontrata të përkohshme me afat derinë zhvillimin e procedurave të ankandit publik. Në një rast kontrata⁷ kishte skaduar me 31/12/2013, qiramarrësi kishte vazhduar ta shfrytëzonte pronën dhe komuna kishte vazhduar ta faturonte në bazë të kontratës së skaduar.

Komuna nuk ka zhvilluar një sistem të brendshëm formal për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim, duke shkaktuar probleme në monitorimin e kontratave sa i përket respektimit të kushteve dhe afateve kontraktuale.

Rreziku Mos aplikimi i procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dëmton parimin e konkurrencës së hapur të tregut dhe

⁷ Kontratat me qira mujore 675€, vlerë vjetore 8,100€.

parimin e ligjshmërisë si dhe mund të rezultojë në nivel më të ulët të arkëtimit të të hyrave.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurohet që prona e paluajtshme e komunës të shfrytëzohet në mënyrë efektive duke pasur parasysh respektimin e kërkesave ligjore me të cilin përcaktohen procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 15,048,291€ prej të cilit gjatë vitit janë shpenzuar 99% të asaj që është buxhetuar apo 14,883,094€. Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

Çështja A5 - Kompensimi i pagave në kundërshtim me Aktin e Emërimit

E gjetura Në tre raste gjatë auditimit kemi identifikuar që shërbyesit civil kompenzohen në kundërshtim me Akt Emërimet, duke u paguar me pak, si në vijim:

- Përgjegjësi në sektorin e katalogimit dhe klasifikimit të librit, sipas kontratës duhet të paguhet me koeficient 7, por sipas listës së pagave paguhet me koeficient 6. Ndryshimi i koeficientit në kontratë nga 6 në 7 është bërë më 01/02/2012 dhe nuk është zbatuar;
- Shefi i Sektorit për Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Akt Emërim duhet të paguhet me koeficient 9, por sipas listës së pagave ai paguhet me koeficient 7.5. Ndryshimi i koeficientit nga 7.5 në 9 në kontratë është bërë më 01/02/2013 por nuk është zbatuar; dhe
- Përgjegjësi në Sektorin Fëmijëve dhe të Rinjëve, me Akt Emërim duhet të paguhet me koeficient 7, por sipas listës së pagave, paguhet me koeficient 6. Ndryshimi i koeficientit nga 6 në 7 është bërë më 01/02/2012.

Kjo ka ndodhur për shkak të gradimit në vitet e më hershme, dhe ndryshimi apo rritja e koeficienteve është bërë pa u siguruar se komuna kishte mundësi financiare apo duke mos marr parasysh ndikimin financiar për këto pozita, të cilët vazhdojnë të paguhen edhe tani në kundërshtim me aktet e themelimit të marrëdhënies së punës.

Rizik Pagesa e punonjësve në kundërshtim me akt emërimet / kontratat e punës përveç që është shkelje ligjor, krijon edhe mundësi që komuna të jetë edhe subjekt i paditur apo përballet me organet e drejtësisë. Kjo mund të rezultojë me shpenzime shtesë të pa planifikuar për diferencën, interesin, gjokat etj.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet që të planifikoj buxhet mjaftueshëm për pagesën e të gjithë punonjësve sipas akt emërimeve të vlefshme që kanë punonjësit në mënyrë që komuna t'iu shmanget padive të ndryshme dhe shpenzimeve të mundshme

shtesë të procedurave gjyqësore apo të filloj dhe zbatoj procedurën administrative për harmonizimin e Akt Emërimeve.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 4,372,924€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,889,511€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e derivateve, udhëtimeve zyrtar brenda/jashtë vendit, shërbime kontraktuese tjera, shpenzime për blerjen e druve, mirëmbajtje etj.

Çështja A6 – Mangësi në certifikimin e pagesave

E gjetura Komuna kishte kontraktuar shërbimet për “Transportin e punëtoreve për nevoja të institucionit” ku ishin specifikuar dy lloje çmimesh për distancën deri në 100 km çmimi ishte 0.35€/km ndërsa për distancën mbi 100km çmimi ishte 1.26€/km. Te pagesa prej 129€, për shpenzime të transportit të artistëve pjesëmarrës, me rastin e manifestimit në Zhegrovës, dy relacione Gjilan - Zhegrovë – Gjilan, (një relacion 52km), komuna kishte paguar çmimin mbi 100 km duke e dëmtuar buxhetin e komunës për 92€.

Komuna kishte bërë pagesën e biletës për fluturim Prishtine- Vjenë- Prishtinë vlerë 363€, në kundërshtim me kërkesën e nenit 3.1 të kontratës ku thuhet që për secilën biletë në pagës duhet të ndodhet vlera e kostos së biletës të dhënë nga sistemi i Amadeusit dhe premiumi i ndarë. Këto gabime kane ndodhur për shkak të neglizhencës në Certifikim të pagesës.

Rreziku Pagesat në mungesë të dëshmive, rrisin rrezikun shërbimet e paguara të mos pranohen në përputhje me kontratën duke ndikuar në dëmtim të buxhetit. Gjithashtu, edhe shërbimet e pranuar që nuk janë në përputhje me kushtet e kontratës, rezultojnë me pagesa të pa rregullta dhe dëmtim të buxhetit komunal.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të forcojë kontrollin në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara dhe në përputhje me kushtet e kontraktuara. Gjithashtu, merren masa për ndalimin e praktikës së parregullt të pagesave për transportin e nxënësve duke kompensuar edhe demin buxhetor nga përgjegjësit.

Çështja B2 - Tejkalimi i vlerës së kontratave

Gjetja Komuna e Gjlani për “Furnizim me dru për ngrohje Lot 1” e nënshkruar me 20/09/2017, vlera e përgjithshme e furnizimit ishte 217,428€, (kontrata nuk ishte kontrate kornizë, por kontratë me terma fiks). Gjatë vitit 2017 dhe 2018, komuna ishte furnizuar me 310,635€⁸ duke tejkaluar kontratën për 93,207€.

Komuna e Gjlani për “Transportin e nxënësve” kontrata kornizë e nënshkruar me 04.12.2015, me vlerë të parashikuar prej 16,780.80€. Gjatë vitit 2015- 2018, komuna kishte marr shërbime të transportit në vlerë prej 37,185€, duke tejkaluar kontratën për 12,292€ më shumë se është e lejuar me LPP.

Kjo ka ndodhur pasi që menaxheri i kontratës nuk mban shënime për nivelin e sasive të furnizuara në funksion të kontrollit për të mos lejuar tejkalimin e sasisë së kontraktuar dhe po ashtu si pasojë që sasia e pamjaftueshme e kontraktuar të përmbush nevojat reale të komunës.

Rreziku Tejkalimi i limitit të përcaktuar të vlerës së kontratës rezulton me një planifikim të dobët të kërkesave të cilat kanë pasuar me vlerësime të pa sakta të para masës dhe përlogarisë.

Rekomandimi B2 Kryetari të siguroj funksionim efikas të kontrolleve në menaxhimin e kontratave. Menaxherët e kontratës duhet të mbajnë shënime adekuate për nivelin e furnizimit të çdo artikulli sipas kontratës kornizë, në mënyrë që furnizimet të bëhen në pajtim me sasi të/vlerën e kontraktuar. Gjithashtu komuna nuk duhet të porosit furnizime më shumë se është e lejuar me kontratë dhe në pajtim me LPP dhe të siguroj që është bërë planifikimi real i nevojave.

⁸ Analizë në bazë të furnitorëve.

Çështja A7 - Vlerësimi i nevojave reale për tenderimin e shërbimeve

E gjetura Sipas nenit 9, paragrafi 1 të LPP-së, para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar.

Komuna për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin ka lidhur kontratë kornizë në vlerë të parashikuar prej 103,600€ përmes procedurës së hapur të prokurimit. Në kërkesën për inicimin e procedurës së prokurimit njësitë kërkuese kanë kërkuar dezinfektimin e 1,000ha hapësirave publike të komunës, komuna realisht ka 1,697ha. Gjatë hartimit të dosjes së tenderit Zyra e Prokurimit e ka rritur sasinë e sipërfaqes për dezinfektim në 79,500ha, duke e marr vlerëne parashikuar në vend të sipërfaqes. Gabimi nuk është vërejtur deri në fillimin e ekzekutimit si pasojë e mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në Zyrën e Prokurimit. Pas vërejtjes së gabimit nga ana e jonë komuna ka kërkuar shkëputjen e kontratës dhe me marrëveshje edhe të OE, e njëjta është shkëputur.

Rreziku Tenderimi i sasive të pasakta përveç që është në kundërshtim me LPP mund të ndikojë që edhe të bëhet keq orientimi i OE të interesuar për të ofertuar dhe të ndikohet në përcaktimin e OE të suksesshëm. Shkëputja e kontratës pas përfundimit të gjithë këtyre procedurave ndikon në vonesa në ekzekutim dhe mos ofrim të shërbimit për qytetarë.

Rekomandimi A7 Kryetari të sigurohet se kontrollet brenda Zyrës së Prokurimit funksionojnë që para se të publikohen dosjet e tenderit të bëhet edhe një rishikim formal i dosjes së tenderit nga zyrtari përgjegjës në mënyrë që të shmangen gabimet e tilla.

Çështja A8 - Angazhim i parregullt i stafit për shërbime të veçanta

Gjetja

Sipas nenit 35.4. të Rregullës financiare NR.01/2013 për shpenzimin i parave publike, pagesa për një individ që nuk është në marrëdhënie pune është blerje e shërbimeve për organizatën buxhetore. Rishikimi ynë i angazhimeve të punëtorëve me kontratë për shërbime të veçanta ka identifikuar se komuna gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 119 punëtorë me kontratë për shërbimetë veçanta. Prej tyre 42 në administratë si zyrtar prokurimi, inxhinier në sektorin e lejeve të ndërtimit, dhe personel sigurimi; 12 në Teatrin e Qytetit si artist; 43 në arsim si zyrtar administrativ, rojtarë shkollash apo pastrues, dhe 22 në shëndetësisimjek të profileve të ndryshme apo infermiere.

Sipas ligji i shërbimit civil Neni 12.4 Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Në 31 të angazhuarit në administratë, 39 raste të angazhuarit në arsim dhe 12 raste të angazhuarit në teatër komuna i ka mbajtur këta punëtor më shumë se 6 muaj brenda një viti duke tejkaluar kufizimin ligjor prej 6 muaj.

Për të angazhuarit në administratë angazhimi i personave ka ndodhur pasi që komuna ka mbi 40 punëtorë të suspenduar për shkak se hetimeve penale nga ana e prokurorisë, ndërsa për stafin tjetër komuna nuk ka buxhet të aprovuar për personel shtesë.

Rreziku

Mbulimi i pozitave të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rrit pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat.

Rekomandimi A8

Kryetari me menaxhmentin e komunës duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta, pasi që rastet e vërejtura nuk kanë të bëjnë me shërbime të veçanta apo kalimtare por janë pozita të përhershme. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,038,177€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 778,398€. Ato kanë të bëjë me Pagesa për përfitues individual, subvencione për entitete publike, transfere për qeveri tjera etj.

Çështja B3 - Ndarja e subvencioneve në kundërshtim me rregulloren komunale

Gjetja Bazuar në nenin 13 të Rregullores komunale për subvencione NR. 2/2018, 01. NR. 016-28468 DT. 22.03.2018, kërkohet që për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit. Në identifikua se subvencioni i ndarë për Teatrin e Qytetit në vlerë prej 8,200€ mungonte marrëveshja siç kërkohet me nenin 13 të Rregullores Komunale.

Gjithashtu, sipas nenit 3 pika 1.2 e Marrëveshjes për Subvencionim, për fituesit obligohen të raportojnë në komunë për mjetet e shpenzuara. Me rastin e subvencionimit të botimit të Librit “Gjilani-terrori, represioni dhe eksodi 1944-1956” në shumën 500€ përfituesi nuk kishte sjellë kurrfarë raporti në komunë. Ngjashëm kishte ndodhur edhe me rastin e subvencionimit të Radio Gjilanit në shumën prej 2,000€, përfituesi nuk kishte sjellë raportet siç kërkohet në nenin 3.2 të marrëveshjes.

Rreziku Dhënia e subvencioneve pa respektuar kriteret e vendosura dhe rregulloren e brendshme komunale, paraqet rrezik që të mos arrihen objektivat e synuara për subvencionet e ndara. Mungesa e raportimeve zbeh përgjegjshmërinë e përfituesve dhe të stafit të komunës gjatë trajtimit të lëndëve si dhe redukton mundësinë e menaxhmentit për ndërmarrjen e veprimeve efektive dhe në kohë.

Rekomandimi B3 Kryetari të siguroj që me rastin e ndarjes së subvencioneve është lidhur marrëveshja përkatëse dhe përfituesit raportojnë për zbatimin e projektit.

Çështja A9 - Tejkallim i shumave të aprovuara për subvencionim

Gjetja Sipas nenit 2 të marrëveshjes për subvencionim në mes të Komunës së Gjilanit dhe Medresesë së Mesme “Alaudin” dega Gjilan, sasia e naftës për ngrohje që e subvenciononte komuna për këtë institucion ishte 2,500 litra. Në baze të faturës nga furnizuesi i derivateve (OE) kjo organizatë në shkurt të vitit 2018 ka përfituar 3,000 litra naftë apo 500 litra më shumë se sa është përcaktuar në marrëveshje (përfitimi në vlerë 2,910€, apo 485€ me shumë).

Gjithashtu, me nenin 4 pika 1.1 të Marrëveshjes, përshihet që komuna duhet ta transferoj në Llogarinë Bankare të përfituesit vlerën e subvencionit, me që rast përfituesi duhet të raportojnë për shumën e shpenzuar në përputhje me nenin 3, të po të njëjtës marrëveshje. Mirëpo shumata i është transferuar kompanisë furnizuese e jo përfituesit. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo efikas të kontrolleve me rastin e shpërndarjes dhe monitorimit të subvencioneve të dhëna.

Rreziku Mungesa e kontrolleve të duhura në respektimin marrëveshjes për subvencionim, bën që buxheti i ndarë për kategorinë e subvencioneve të mos shpenzohet për qëllimet e planifikuara dhe planet të mbesin të pa përmbushura.

Rekomandimi A9 Kryetari, duhet të siguroj që pagesat për subvencione të jenë në harmoni me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve, vendimet dhe marrëveshjet për subvencionim si dhe se pagesat nga kjo kategori të bëhen vetëm përfitueseve.

Çështja A10 - Ndarje subvencioneve pa shpallje publike

Gjetja Sipas nenit 12 të rregullores komunale të subvencioneve, procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike ku përcaktohen kriteret dhe procedurat e aplikimit. Për projektin “Gëzuar Viti i Ri 2018” në vlerë 3,850€ Komuna nuk kishte aplikuar procesin e aplikimit përmes thirrjes publike në këtë procedurë, tek në gjysma e dytë të vitit 2018 komuna kishte filluar të aplikon thirrej publike për subvencionim.

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të rregullores, redukton objektivitetin dhe transparencën gjatë ndarjes së subvencioneve dhe shton rrezikun për mos arritjen e objektivave të përcaktuara të subvencionit të dhënë.

Rekomandimi A10 Kryetari, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet në procesin e ndarjes së subvencioneve, dhe se përfituesit i plotësojnë kriteret në bazë të cilave është lejuar subvencioni bazuar në rregullore.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale në vitin 2018 është 6,052,544€. Prej tyre, ishin shpenzuar 4,802,248€ apo 79% e buxhetit. Investimet kapitale marrin pjesë me 19%, e shpenzimeve të gjithmbarshëm të komunës.

Çështja C1 - Dobësi në menaxhim të kontratave

Gjetja Ndryshimi i projektit apo kontratës së shpërblyer fillestare sipas pikës 61.21 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik ndryshohet dhe përgatitet nga ana e Departamentit të Prokurimit si dhe merret aprovimi nga ZKA për ndryshim sipas 61.23 i Udhëzuesit Operativ të prokurimit publik. Gjithashtu, zyrtari përgjegjës i caktuar nga ZKA duhet të ketë parasysht se me ndryshimin e kontratës së punëve të projektit të cilat nuk ishin paraparë në kontratën fillestare, bazuar në nenin 35.2.4 dhe 35.3, vlera e punës së pjesës së ndryshuar nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e vlerës së kontratës fillestare.

Në pesë pagesa në vlerë prej 89,948.45€ të cilat i përkasin projektit për rregullimit të shtratit të lumit Mirusha, kemi vërejtur ndryshime në pozicione nga paramasa

e kontraktuar me atë të realizuar. Këto ndryshime janë bërë si rezultat i kërkesës së banorëve dhe të cilat ndryshime janë aprovuar në papajtueshmëri me procedurat nga Kuvendi Komunal. Sa për ilustrim: si rezultat i vendimit të KK punët e shtratit dhe kanalizimit ishin të kontraktuara në vlerë 1,818,730€ ndërsa janë ekzekutuar 538,189€ apo 70% më pak, punët e mbulimit në kanalizim ishin të kontraktuara 389,088€ janë realizuar 1,208,033€ apo 210% me shumë.

Kryesuesja e kuvendit është vet caktuar si menaxhere kontratës derisa emërimin e menaxherit të projektit e cakton ZKA nga a) personeli i njësisë kërkuese, b) ndonjë njësi tjetër, si dhe c) projekti që ka vlerë të madhe duhet të caktohet një Ekip për menaxhimin e kontratës; siç ishte rasti i këtij projekti.

Rreziku Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e kontratës. Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit mund të rezultojë me trajtim jo të barabartë të ofertuesve, pagesa të parregullta dhe vlerë të ulët për para.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë respektimin konsistentë dhe efektiv të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe kuvendi duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave.

Çështja C2 - Projekte pa plan detal të ndërtimit

Gjetja Nga gjashtë rastet⁹, e audituara, asnjëri nga këto projekte nuk ka plan detal të ndërtimit, kërkesë e nenit 28.10 të LPP-së, i cili definon qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedoj një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të proceduarve të kontraktimit të punëve. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së komunës lidhur me këtë problematike.

Rreziku Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit rezulton me anashkalim të kërkesë ligjore dhe mundëson realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara, studiuara dhe mund të rezulton me shpenzime të paparashikuar apo ofrojnë vlerë të dobët për parënë e shpenzuar të taksapaguesit.

Rekomandimi C2 Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e kontraktimit të

⁹1.Asfaltimi I rrugëve në fshatrat dhe qytetin e Gjilanit Lot 4 Rruga "Pajazit Ahmeti"; 2.Asfaltimi I rrugëve në fshatrat dhe qytetin e Gjilanit- Rruga Perlepnice; 3.Ndertimi I terrenit sportiv për futboll të vogël -hendboll-basketboll dhe volejboll në fshatin Pogragje;4.Ndertimi I urës në fshatin Gumnisht; 5.Ndertimi I rrugës së Kumanovës (faza e pare, krahët 1-9); dhe 6.Asfaltimi I rrugëve "Hysen Terpeza" në Arbëri.

punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në rast të kundërt procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.

Çështja B4 – Inicimi i projekteve pa buxhet të mjaftueshëm

Gjetja Rregulla financiare 01/2013 MF-Për shpenzimin e parasë publike Neni 12, pika 2, ku thuhet: LMFPP neni 36.1 kërkon që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK në përputhje me rregullat MFK. Ne kemi gjetur se:

- Projekti “Ndërtimi i terrenit sportiv për futboll të vogël-hendboll-basketboll dhe volejboll në fshatin Pogragjë”, kontrata është nënshkruar në shumë prej 22,569€, ndërsa kanë qenë të zotuarat mjetet në shumën prej 12,500€.
- Projekti “Asfaltimi i rrugëve Hysen Tërpeza në Arbëri” kontrata është nënshkruar në shumën prej 202,487€, ndërsa zotimi në vlerë prej 150,000€

Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur për shkak që projektet financohen nga të hyrat vetjake, zotimet bëhen sipas realizimit të të hyrave në kohë.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme e rrit rrezikun e vonësive të zbatimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të forcoj kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas raportit në SIMFK vlera neto e pasurisë kapitale mbi 1,000€ është 211,792,728€, ndërsa vlera e pasurisë nën 1,000€ është 1,480,777€. Pagesat e ekzekutuara për investime kapitale gjatë vitit 2018 ishin 4,802,248€, ndërsa pasuria e regjistruar gjatë vitit 2018 arrin vlerën prej 6,675,950€. Kjo diferencë ishte si rezultat i bashkëfinancimeve me nivelin qendror, donacioneve si dhe investimeve në vijim të viteve paraprake të cilat janë përfunduar dhe regjistruar si pasuri në vitin 2018. Përveç çështjeve të theksuar të kapitulli i PFV, ne nuk kemi identifikuar gjetje tjera në këtë fushë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2018, llogaritë e arkëtueshme (LL/A) të shpalosura arrinin vlerën 10,437,560€ prej tyre Licencat për biznes (veprimtaritë banesore) në vlerë 1,791,450€; Qiraja 318,760€; Tatiminë pronë 8,287,500€; PPP (Partneriteti Publiko Privat) në vlerë 33,400€ dhe Inkubatori në vlerë 6,450€. Krahasuar me vitin 2017, LL/A, kishin pësuar rritje prej 8.7% apo në vlerë 841,880€¹⁰, rritja është reflektuar në kategorinë e Tatimit në prone (862,600€), dhe Licencat e biznesit (8,650€), për shkak të mungesës së vendosjes së mekanizmave nga komuna për rritjen e arkëtimin të këtyre të hyrave.

Çështja A11 - Vonesa në arkëtimin e të hyrave nga qiratë

Gjetja Sipas kontratave¹¹ të nënshkruara nga ana e komunës si qiradhënës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës pagesa e qirasë mujore duhet të bëhet çdo fillim muaji varësisht nga kushtet e përcaktuara në këto kontrata. Në katër raste nga tetë sa kemi audituar kishte vonesa në shlyerjen e obligime të qiramarrësve ndaj komunës, në dy prej tyre komuna nuk kishte ndërmarr asnjë hap për arkëtimin e këtyre të hyrave. Ndërsa në dy rastet tjera, në njërin kishte aplikuar vërejtje me shkrim e tjetrën kishte ngritur padi për mos pagese. Shuma totale e borxhit që këta qiramarrës kishin ndaj komunës ishte 21,229€.

Mos faturimi i rregullt sipas kushteve të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës duke mos lëshuar fature por vetëm nëse pala personalisht e kërkon dhe për shkak edhe të mos gatishmëria të komunës për të ndërmarrë masa efikase për arkëtimin e të hyrave ka ndikuar në vonesa të arkëtimin të të hyrave.

Rreziku Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna në shfrytëzim rrit rrezikun që komuna të ketë një performancë të ulët në mbledhjen e të hyrave, mos realizim të planit si dhe rritjen e vlerës së llogarive të arkëtueshme të komunës. Mos aplikim i masave shtesë ndikon edhe në rezistencën e qiramarrësve për t'ju përgjigjur komunës apo paguar me kohë obligimin e qirasë.

Rekomandimi A11 Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në pajtim me kushtet e kontraktuar, përkatësisht zbatimin e afateve për faturimin dhe arkëtimin e mjeteve nga qiraja.

¹⁰ LIA janë zvogëluar edhe për 29,370€ te qiratë.

¹¹ 1. Kontrata 02 nr. 355, dt:27.05.2013(pagesa më së largu deri më datë 10 të muajit vijues), 2. Kontrata 02 nr. 773, dt:15.09.2017(pagesa jo më larg se datë 05 e muajit vijues), 3. Kontrata nr. 10-464-9666, dt:29.01.2016(pagesa me së largu deri më datë 10 të muajit vijues), 4. Kontrata 02 nr. 721, dt:18.11.2014(pagesa çdo fillim muaji).

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 7,786 milion€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna. Përveç çështjeve të raportuara te pasqyrat nuk kemi identifikuar gjetje tjera.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Gjilanit veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektivendaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor menaxhimit financiar, nuk janë të vendosura. Komiteti i auditimit nuk është i themeluar ende, ndërsa sipas gjykimeve tona auditimi i brendshëm ende nuk e ka pavarësinë e duhur të veprimit. OB nuk kishte përmbushë as kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjikenë nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Konsiderojmë se komuna ka arrit ti hartojë dhe i posedon këto plane/strategji.

OB në përgjithësi ka kontrollë të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në Komunë në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Komuna ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Gjatë vitit 2018 kjo njësi ka kryer gjithsejtë 13 auditime duke e përfshirë edhe auditimin për rishikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve. Bazuar në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve prej 24 rekomandimeve të dhëna, plotësisht janë duke u zbatuar 15 rekomandime, në proces janë tetë (8) rekomandime, ndërsa një (1) rekomandim ende nuk është duke u zbatuar.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja B5 - Dobësi në kontrolle menaxheriale

- Gjetja** Si pasojë e mosfunksionimit të duhura të kontrolleve menaxheriale menaxhimi jo i mirë i pranimit dhe përcjelljes së faturave ka ndikuar në shpalosje jo të plotë dhe të saktë. Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në veçanti në menaxhimin e të hyrave, të shpenzimeve duke i klasifikuar në kode adekuate, proceseve të prokurimit, menaxhimin e pasurive jo financiare, si dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.
- Rekomandimi B5** Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Gjilanit ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjendja e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak ishte: pesë (5) rekomandime të zbatuara, tre (3) rekomandime të pazbatuara të mbyllur, pesë (5) rekomandime të përsëritura si dhe dy (2) rekomandime pjesërisht të zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalsjen e obligimeve të papaguara dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa në përmirësim të procesit raportues.	Rekomandim i pa zbatuar (i përsëritur).
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari, të sigurojë se planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve bëhet konform natyrës së shpenzimeve, në mënyrë që klasifikimi i shpenzimeve bëhet sipas kategorive adekuate.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa, shuma e keq klasifikimit veç se është rritur duke kaluar nivelin e materialitetit.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar. (I përsëritur për shkak të shumes materiale raportohet tek theksimi i çështjes).
3	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që të merren masa të nevojshme në mënyrë që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të jenë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë.		Rekomandim i zbatuar.

4	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari, të siguroj se aplikohen kontrolle të duhura në procesin deri të nënshkrimi i kontratës, me ç'rast vërtetohet se të dhënat në përmbajtjen e kontratës janë të sakta.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë.	Rekomandim i zbatuar.
5	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj se ndarja e subvencioneve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në rregullore, përfshirë monitorimin e duhur të shpenzimit të tyre, në mënyrë që subvencionet e dhëna të arrijnë qëllimin e synuar.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar (i përsëritur).
6	Investimet kapitale	Kryetari, të siguroj se janë marrë masa për publikimin e të gjitha vendimeve lidhur me shpronësimet e bëra dhe më tutje për çdo proces të tillë në të ardhmen, të publikohen vendimet sipas kërkesave ligjore.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar në ndonjë rast të tillë.	Rekomandim i zbatuar.
7	Investimet kapitale	Kryetari, të rishikoj arsyet e dështimit të kontrolleve në përgatitjen e tenderimeve për kontrata ndërtimi dhe të siguroj se projektet e synuara janë qartë të definuara. Më tutje, me rastin e pranimit të situacioneve për pagesë, të siguroj se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar, përfshirë edhe dëshmitë mbi lokacionet e vend punimeve.	Konsideroj më se hartimi i projekteve nuk realizohet as këtë vit. Auditori nuk ka gjetë për pranimin teknik.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar (pjesërisht i përsëritur).
8	Investimet kapitale	Kryetari, të sigurojë se çdo projekt të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat ndërtimore, më tutje të sigurojë se forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik, si dhe aty ku është e nevojshme të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, në mënyrë që të rritet përgjegjësia tek operatorët ekonomik.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar (i përsëritur i modifikuar).
9	Investimet kapitale	Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e mjaftueshme për realizimin e saj në periudha të parapara.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar (i përsëritur).

10	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari të siguroj kontrole shtese në menaxhimin e kontratave në mënyrë që punët/furnizimet bëhen në pajtim me sasi të/vlerën e kontraktuar dhe komuna nuk hyn në obligime përtej kontratës.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar (i përsëritur).
11	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë veprimet për korrigjimin e regjistrit të pasurisë, me ç'rast blerjet që nuk rezultojnë në një pasuri ose përmirësim të pasurisë, nuk regjistrohen në regjistrin kontabël. Më tutje, regjistri i pasurisë duhet të posedojë të gjitha të dhënat përkatëse, përfshirë edhe lokacionin e tyre.	Përmes pagesave të identifikuara si keq klasifikim kemi konfirmua zbatimin e rekomandimit.	Rekomandim i zbatuar.
12	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të siguroj që janë marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të behët në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Më pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi. Gjithashtu, duhet të sigurojë që të gjitha mallrat dhe shërbimet pranohen përmes komisioneve të themeluara për pranimin e tyre.	Nuk është ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar (I përsëritur për shkak të shumës materiale raportohet tek theksimi i çështjes).
13	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Komunë vazhdon të ketë një numër të konsiderue shëm të rekomandimeve të pa zbatuar apo në proces të zbatimit.	Rekomandim i pa zbatuar i mbyllur.

14	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari të siguroj se ka rritë bashkëpunimin me NjAB dhe KA, si dhe të merr masa në ngritjen e gatishmërisë së menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së, për një funksionim më efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.	Konsideroj më se 63% e rekomandi meve janë zbatuar, 33% janë në proces, dhe vetëm 1 (apo 4%) nuk është zbatuar.	Rekomandim i zbatuar.
15	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, dCuke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të pasuroj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Nuk është ndërmarrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar (i përsëritur).
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	2.3 Rekomandimet lidhur me PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për theksimin e çështjes. Të gjitha shpenzimet duhet të paguhen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit. Më tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e të gjithë pasurisë si dhe obligimeve të papaguara dhe të shpalosen drejt në pasqyrat financiare duke u mbështetur me dokumentacion përkatës. Duhet të ndërmerren veprime specifike për çështjeje tjera të ngritura lidhur me PVF, për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	3.1- Realizimi i ulët i buxhetit për Investime kapitale dhe Subvencione	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.		
3	3.1.1 Parregullsi në kalkulimin e	Kryetari duhet të kërkojë nga menaxheri i tatimit në pronë që gjatë procesit regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes jo vetëm regjistrimit të pronave të reja dhe ndryshimeve fizike që ndodhin		

	të hyrave nga tatimin në pronë	në pronat ekzistuese dhe por edhe korrigjimet e dobësive të identifikuar të cilat kanë të bëjnë me informatat e pronave të tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që përlllogaritjet e ngarkesave tatimore të jene sa më reale.
4	3.1.1 Informata jo të plota në dosjet e tatimpaguesve	Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e Tatimit në Pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuar, dhe ta mbikëqyrë baza të rregullta zbatimin e atij plani duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuar.
5	3.1.1 Prona komunale të dhëna në shfrytëzim të përkohshëm pa procedura të ankandit	Kryetari duhet të sigurohet që prona e paluajtshme e komunës të shfrytëzohet në mënyrë efektive duke pasur parasysh respektimin e kërkesave ligjore me të cilin përcaktohen procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
6	3.1.2 Kompensimi i pagave në kundërshtim me akt emërimet	Kryetari duhet që të planifikoj buxhet mjaftueshëm për pagesën e të gjithë punonjësve sipas akt emërimeve të vlefshme që kanë punonjësit në mënyrë që komuna t'iu shmanget padive të ndryshme dhe shpenzimeve të mundshme shtesë të procedurave gjyqësore apo të filloj dhe zbatoj procedurën administrative për harmonizimin e Akt emërimeve.
7	3.1.3 -MSH- Mangësi në certifikimin e pagesave	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmimeve të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara dhe në përputhje me kushtet e kontraktuara. Gjithashtu, merren masa për ndalimin e praktikës së parregullt të pagesave për transportin e nxënësve duke kompensuar edhe demin buxhetor nga përgjegjësit.
8	3.1.3 Tejkalimi i vlerës së kontratave	Kryetari të siguroj funksionim efikas tek kontrollet e menaxhimit të kontratave. Menaxherët e kontratës mbajnë shënime adekuate përnivelin e furnizimit të çdo artikulli me kontratë kornizë, në mënyrë që furnizimet bëhen në pajtim me sasi të/ vlerën e kontraktuar dhe komuna nuk porosit furnizime më shumë se është e lejuar me kontratë dhe me LPP, sikurse duhet të siguroj që është bërë planifikim real i nevojave.
9	3.1.3 Tenderimi i sasive më të larta se sa sasi të kërkuara, nevojat reale	Kryetari të sigurohet se kontrollet brenda Zyrës së Prokurimit funksionojnë që para se të publikohen dosjet e tenderit të bëhet edhe një rishikim formal i dosjes së tenderit nga zyrtari përgjegjës në mënyrë që të shmangen gabimet e tilla.
10	3.1.3 Angazhim i parregullt i stafit për shërbime të veçanta	Kryetari me menaxhmentin e komunës duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta, pasi që rastet e vërejtura nuk kanë të bëjnë me shërbime të veçanta apo kalimtare por janë pozita të përhershme. Nevoja për staf shtesë për pozitën e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore.

11	3.1.4-ST- Ndarja e subvencioneve në kundërshtim me rregulloren komunale	Kryetari të siguroj që me rastin e ndarjes së subvencioneve është lidhur marrëveshja përkatëse dhe përfituesit raportojnë për zbatimin e projektit.
12	3.1.4 Tejkallim i shumave të aprovuara për subvencionim	Kryetari, duhet të siguroj që pagesat për subvencione të jenë në harmoni me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve, vendimet dhe marrëveshjet për subvencionim si dhe se pagesat nga kjo kategori të bëhen vetëm përfitueseve.
13	3.1.4 Ndarje subvencioneve pa shpallje publike	Kryetari, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet në procesin e ndarjes së subvencioneve, dhe se përfituesit i plotësojnë kriteret në bazë të cilave është lejuar subvencioni bazuar në rregullore.
14	3.1.5 IK- Dobësi në menaxhim të kontratave	Kryetari duhet të sigurojë respektimin konsistentë dhe efektiv të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave.
15	3.1.5 Projekte pa plan detal të ndërtimit	Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në rast të kundërt procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.
16	3.1.5 Inicimi i projekteve pa buxhet të mjaftueshëm	Kryetari duhet të forcoj kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.
17	3.3-LLA- Vonesa në arkëtimin e të hyrave nga qiratë	Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në pajtim me kushtet e kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për faturimin dhe arkëtimin e mjeteve nga qiraja.
18	4.2- Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:


- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, kk.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjiçanit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


z. Lutfi Haziri
Kryetar i Komunës,
Data: 25.Maj.2019, Gjiçanit

